URDHËR
Nr. 94, datë 27.3.2018

MBI RAPORTIMIN FINANCIAR TË SHOQËRIVE TË UJËSJELLËSVE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë; të ligjit nr. 9000, datë 30.1.2003, "Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave"; të nenit 61, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar; të nenit 6, germa "dh", të ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010, "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", të ndryshuar, si dhe të nenit 37, të ligjit nr. 10091, datë 5.3.2009, "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe kontabilistit të miratuar", të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Të gjitha shoqëritë e ujësjellës-kanalizimeve që janë qendër qarku, brenda datës 30 maj të çdo viti, pas mbylljes së vitit ushtrimor, duhet të paraqesin një raport, pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, për çështjet e parashikuara sipas procedurës të përshkruar në aneksin nr. 1 bashkëlidhur këtij urdhri.

2. Raporti përgatitet nga një audites ligjor, shoqëri auditimi ose bashkim operatorësh ekonomikë të licencuar për auditim ligjor, në përputhje me:

- Standardin ndërkombëtar mbi shërbimet e lidhura ISRS 4400, "Angazhimet për të kryer procedurat e dakorduara në lidhje me informacionin financiar", të shpallur nga Federata Ndërkombëtare e Kontabilistëve (IFAC);
- Kodin e Etikës për Profesionistët Kontabël (hartuar dhe publikuar nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Etikës për Kontabilistët (IESBA) të Federatës Ndërkombëtare të Kontabilistëve (IFAC), i cili përcakton parimet etike thelbësore për audituesit, lidhur me integritetin, objektivitetin, pavarësinë, kompetencën profesionale dhe kujdesin e duhur, konfidencialitetin, sjelljen profesionale dhe standardet teknike. Edhe pse ISRS 4400 kërkon që pavarësia nuk është kusht për angazhimet në shërbimet e dakorduara, institucioni kontraktues duhet të kërkojë që audituesi të jetë i pavarur nga i kontraktuari dhe të jetë në pajtueshmëri me kërkesat për pavarësinë e kërkuar nga Kodi i Etikës për Profesionistët Kontabël dhe pikën 4 të këtij urdhri.

3. Raporti që do të lëshohet do të ketë natyrën e një raporti të gjetjeve faktike, të përgatitur në përputhje me standardet e pranuara të etikës, integritetit dhe kompetencave profesionale.

4. Audituesit që angazhohen në shërbimet e kryerjes së procedurave të dakorduara, sipas ISRS 4400, nuk duhet të jenë të angazhuar, në dy vitet e fundit, në shërbimet e auditimit ligjor apo në shërbimet e konsulencës financiare apo shërbimeve të kontabilitetit pranë shoqërisë së ujësjellësit ku do të realizojnë angazhimet për të kryer procedurat e dakorduara. Gjithashtu, këta audites nuk duhet të kenë marrë asnjë masë disiplinore nga Bordi i Mbikëqyrjes Publike, gjatë kryerjes së angazhimeve të tyre në fushën e auditimit ligjor, konsulencës financiare dhe kontabilitetit.

5. Personeli i angazhuar nga audituesit ligjorë apo shoqëritë e auditimit nuk duhet të jenë në kushtet e konfliktit të interesit me personat e ngarkuar me drejtimin e shoqërive të ujësjellësve.

6. Audituesi ligjorë/shoqëria e auditimit duhet që të ketë eksperiencë në shërbimet e procedurave të dakordësuara. Partneri i angazhimit duhet të ketë të paktën 5 vjet që ka fituar titullin e audituesit ligjor dhe ai ose një nga personat e angazhuar në stafin e tij duhet të zotërojë titullin e audituesit të brendshëm të certifikuar për sektorin publik.

7. Kostot e shërbimit mbulohen nga shoqëritë e ujësjellësve.

8. Formati i raportit përgatitet dhe miratohet nga Bordi i Mbikëqyrjes Publike, jo më vonë se 2 javë nga hyrja në fuqi e këtij urdhri.

9. Ky raport përgatitet të paktën një herë në vit, me përjashtim të shoqërive të ujësjellësve në Tiranë, Vlorë, Durrës, Fier, Elbasan dhe Shkodër, të cilat për shkak të madhësisë së aktivitetit të tyre, duhet të raportojnë edhe për gjysmën e parë të vitit. Raporti për gjysmën e parë të vitit duhet të paraqitet pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë brenda datës 30 shtator.

10. Ngarkohen për zbatimin e këtij urdhri të gjitha shoqëritë e ujësjellësve në Republikën e Shqipërisë, të parashikuara në pikën 1 të këtij urdhri, si dhe Ministria e Financave dhe Ekonomisë.

11. Ngarkohet Bordi i Mbikëqyrjes Publike për ushtrimin e kontrollit të cilësisë ndaj audituesve ligjorë dhe shoqërive të auditimit të angazhuara në këto misione.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI I FINANCAVE DHE EKONOMISË
Arben Ahmetaj

ANEKS NR. 1
PROCEDURA MBI PARAQITJEN E RAPORTIT TË SHOQËRIVE TË UJËSJELLËS-KANALIZIME NË MINISTRINË E FINANCAVE DHE EKONOMISË

Audituesit ligjorë, shoqëritë e auditimit apo bashkimet e operatorëve ekonomikë të licencuar për auditim ligjor, në raportin me gjetjet faktike, si dhe bazuar në evidencën financiare dhe jofinanciare deri më 31 dhjetor, duhet të:

a) Krahasojnë shpenzimet faktike të vitit sipas librave kontabël me ata të buxhetuar dhe të japin shpjegime mbi diferencat;

b) Krahasojnë buxhetin fillestar të vitit me ndryshimet e kryera në këtë buxhet gjatë vitit dhe të verifikojnë miratimin e tyre;

c) Verifikojnë nëse është kryer inventari fizik i aktiveve afatgjata materiale dhe numërimi i mjeteve monetare në arkë në fund të vitit ushtrimor;

ç) Marrin informacion nga shoqëria përkatëse e ujësjellës-kanalizimeve mbi detyrimet e prapambetura, dhe të verifikojnë rakordimin me librat kontabël analitikë (kartelat e furnitorëve), duke analizuar ekzistencën e detyrimeve pa identitet. Në lidhje me këto detyrime, duhet të verifikohet edhe vjetërsia e tyre në: deri në 1 vit, nga 1–5 vjet dhe mbi 5 vjet, të grupuar në detyrimet ndaj:

- OSHEE-së;
- Administratës tatimore dhe doganore;
- Institucioneve buxhetore;
- Institutit të Sigurimeve Shoqërore;
- Punonjësve;
- Çështjeve gjyqësore;
- Të tjera detyrime, nëse janë më shumë se 10% e totalit te tyre.

Gjithashtu, audituesit ligjorë, shoqëritë e auditimit apo bashkimet e operatorëve ekonomikë të licencuar për auditim ligjor, duhet të verifikojnë nëse ka aktmarrëveshje për shlyerjen e çdo detyrimi të prapambetur;

d) Marrin informacion nga shoqëria përkatëse e ujësjellës-kanalizimeve mbi planin e biznesit të përgatitur për huamarrje nga bankat (nëse ka) dhe të krahasojnë të dhënat faktike, sipas pasqyrave financiare më të fundit, duke identifikuar diferencat në rezultatin përfundimtar të *cash-flow*;

dh) Marrin informacion nga shoqëria përkatëse e ujësjellës-kanalizimeve për tarifat sipas kategorive: familjarë, biznese, institucione, në lidhje me çështjet si më poshtë:

- Furnizimit me ujë;
- Kanalizimit të ujërave të ndotura;
- Furnizimit të ujit me shumicë; dhe
- Tarifave e lidhjeve të reja.

Në vijim të këtij informacioni, audituesit ligjorë duhet të verifikojnë nëse janë miratuar nga ERRU-ja, nëse ka diferencim sipas zonave dhe sa është ky diferencim, si dhe të kontrollojnë një kampion të rastësishëm prej 40 rastesh, për zbatimin e këtyre tarifave gjatë gjithë periudhës, që është subjekt kontrolli.

e) Marrin informacion mbi klientët e analizuar nga shoqëria përkatëse e ujësjellës-kanalizimeve, në lidhje me numrin total të klientëve (nga të cilët sa janë klientë pa matës), si dhe shumat e arkëtuara, grupuar sipas kategorive në vijim:

- Familjarë;
- Biznese;
- Institucione.

Në vijim të këtij informacioni, audituesit ligjorë duhet të verifikojnë nëse arkëtimet rakordojnë me librat kontabël analitikë (libri i arkës, bankës dhe/ose kartelat e klientëve), si dhe nëse numri i klientëve me dhe pa matës rakordon me numrin e njësive, sipas projektit të adresarit;

ë) Analizojnë për kategoritë në pikën "g" më sipër, historikun e marrëdhënieve me klientët (arkëtime,

faturime etj.) dhe të identifikojnë klientët që nuk kanë veprime nga 1–5 vjet dhe mbi 5 vjet, si dhe ekzistencën e klientëve pa identitet;

f) Marrin informacion nga shoqëria përkatëse e ujësjellës-kanalizimeve, mbi:

- Prodhimin e ujit;
- Humbjet e ujit në rrjet (teknike dhe/ose administrative);
- Sasinë e ujit të shitur/faturuar;
- Investimet nga burimet e veta; si dhe
- Të verifikojnë nëse të dhënat sintetike rakordojnë me të dhënat e regjistrave përkatës analitikë;

g) Marrin informacion nga shoqëria përkatëse e ujësjellës-kanalizimeve mbi vlerën e faturuar për bizneset, sipas kategorisë se faturimit dhe tarifës së aplikuar për çdo kategori. Gjithashtu, duhet të verifikojnë nëse vlera e faturuar rakordon me librat analitikë kontabël (p.sh., totalin e kartelave të klientëve);

gj) Marrin informacion nga shoqëria përkatëse e ujësjellës-kanalizimeve mbi shpenzimet operative, si dhe të verifikojnë nëse rakordojnë me kartelat analitike të kontabilitetit, duke rishikuar për keqklasifikime apo për zëra të pazakonshëm, në lidhje me kategoritë në vijim:

- Pagat bruto;
- Mirëmbajtjen dhe riparimet;
- Energjinë elektrike;
- Karburantin;
- Kimikatet;
- Shpenzime auditimi ligjor, konsulenca ligjore, tatimore, financiare dhe të tjera biznesi;
- Shpenzime të tjera operative.

Gjithashtu, audituesit ligjorë, shoqëritë e auditimit apo bashkimet e operatorëve ekonomikë duhet të llogarisin sa është totali i shpenzimeve operative;

h) Marrin informacion nga shoqëria përkatëse e ujësjellës-kanalizimeve mbi ankesat nga konsumatorët, të grupuara sipas natyrës së ankesës. Gjithashtu, duhet të verifikojnë numrin total të ankesave të marra, numrin e ankesave të zgjidhura, të refuzuara dhe pa përgjigje, të dhëna të cilat mbështeten në regjistrin analitik të ankesave;

i) Marrin informacion nga shoqëria përkatëse e ujësjellës-kanalizimeve mbi numrin total të matësve për burime dhe puse, si dhe të verifikojnë nëse rakordojnë me të dhënat analitike të regjistrave të matësve;

j) Rishikojnë mbajtjen e regjistrit për sistemet e furnizimit me ujë të ndërtuara nga qytetarët;

k) Rishikojnë nivelin e transparencës në ngritjen e mekanizmave për furnizimin me ujë të familjeve në nevojë pa pagesë, që sigurojnë të paktën 20 litër/ditë/frymë;

l) Bëjnë verifikime të tjera, që lidhen me natyrën specifike sipas së cilës operon subjekti, të cilat miratohen me urdhër të ministrit të Financave dhe Ekonomisë.